

Përkrahur nga:



Financuar nga:



Implementuar nga:



OJQ - BRO - NGO
Roma in Action
Gjakovë

Regjistrimi Civil

Realizimi i të drejtave të komuniteteve
Rom, Ashkali dhe Egjiptian

*Ky dokument është hartuar nga:
Instituti i Kosovës për Drejtësi-IKD,
dhe Roma in Action - RiA*

Instituti i Kosovës për Drejtësi-IKD, që nga muaji shkurt i vitit 2021, ka realizuar takime të vazhdueshme në terren me pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ku ka ofruar ndihmë juridike dhe këshilla juridike falas si dhe ka analizuar për së afërmi problemet me të cilat këto komunitete përballen në baza ditore.

Roma in Action- RiA ka përvojë mbi 5 vjeçare në avancimin e pozitës së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me fokus tek të rinjtë.

Me anë të këtij dokumenti, IKD dhe RiA, synojnë që të sjellin vëmendjen e institucioneve kompetente në një nga problemet kryesore të identifikuara përgjatë vizitave dhe takimeve me komunitete - çështja e regjistrimit civil.

Gjetjet në terren

Pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përballen me problemin e mosregjistrimit në regjistra civil, ku si pasojë u pamundësohet qasja në të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale e kulturore. Përkatësisht, të njëjtit nuk mund të arsimohen, të punësohen, apo t'u qasen shërbimeve sociale dhe të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë dhe ligj.

IKD dhe RiA, në bazë të hulumtimeve të realizuara dhe vizitave në terren, vlerësojnë se disa nga sfidat kryesore lidhur me problemin e mosregjistrimit në regjistra civil, janë:

- mungesa e informatave lidhur me procedurat për regjistrim;
- mungesa e informatave lidhur me rëndësinë e regjistrimit.

Përkundër faktit që rastet e cekura më poshtë janë të rregulluara me ligj, IKD ka vërejtur se mosregjistimi në regjistra civil është ndërlidhur edhe me rastet e:


- fëmijëve të lindur jashtë spitaleve;
- fëmijëve të lindur nga prindër të cilët nuk janë të regjistruar;
- fëmijëve të lindur nga nënat nën moshën madhore.

Realizimi i të drejtës së identitetit ligjor është edhe prioritet i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Më saktësisht, objektiva 16.9 synon: të sigurojë identitetin ligjor për të gjithë, duke përfshirë regjistrimet falas të lindjeve.



Rekomandimet

Edhe pse legjislacioni në fuqi e rregullon me saktësi çështjen e regjistrimit civil dhe ofron lehtësira për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian (sikur lirimi nga gjoba për regjistrim të vonshëm si dhe lirimi nga tarifatat për regjistrimin e lindjeve dhe regjistrimet e mëvonshme) më shumë punë duhet të bëhet për të arritur tek integrimi i plotë i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Andaj, IKD dhe RiA rekomandojnë që:



Institucionet të luajnë një rol më proaktiv duke arritur tek komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes mekanizmave mobil, në mënyrë që të sigurojnë qasje më praktike në të drejtën e këtyre komuniteteve për tu regjistruar në regjistra civil.



Institucionet shtetërore të rrisin përpjekjet dhe aktivitetet e tyre në drejtim të vetëdijësimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian lidhur me rëndësinë dhe mënyrën e regjistrimit në regjistra civil.



Institucionet kompetente të veprojnë në përputhje me obligimet dhe kompetencat e tyre duke zbatuar saktë dhe në mënyrë të plotë legjislacionin në fuqi, për t'ia mundësuar secilit qytetar të Republikës së Kosovës realizimin e të drejtës për tu regjistruar në regjistra civil.